



Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve

Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve

**Analizë mbi përdorimin e monedhës kombëtare në tregjet
financiare, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes
Financiare**

Gusht 2025

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
I. Hyrje.....	3
II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve	4
A. Tregu i sigurimeve	4
1. Informacion mbi primet e shkruara bruto	4
Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit.....	6
Informacion mbi Investime të tjera financiare të shoqërive të sigurimit	11
B. Tregu i Kapitaleve	12
C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve.....	16
III. Përfundime	18

I. Hyrje

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare” në muajin prill të vitit 2017, ku angazhohen të ndër marrin veprime për të ulur nivelin e përdorimit të monedhave të huaja në ekonomi sipas sektorëve të cilët mbikëqyrin, monitorojnë apo operojnë në aktivitetin e tyre.

Duke qenë se në vendin tonë është krijuar një traditë e përdorimit të gjerë të monedhave të huaja (valutat), kryesisht të Euros dhe dollarit amerikan, masat që duhet të ndërmerren për minimizimin e përdorimit të monedhave të huaja duhet të jenë të kujdesshme dhe të argumentuara, për të qenë efektive.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (më tej, Autoriteti) monitoron me kujdes përdorimin e monedhave të huaja në tregjet financiare nën mbikëqyrje. Lidhur me veprimtarinë në valutë, në këtë raport janë përfshirë:

Informacion për tregun e sigurimeve sipas produkteve dhe investimeve nga shoqëritë, informacion për fondet e investimeve dhe të pensioneve vullnetare private. Disa nga produktet financiare të këtyre institucioneve, operojnë në valutë për arsye objektive.

Të tillë janë, për shembull disa produkte të sigurimit të detyrueshëm motorik, si polica kufitare dhe kartoni jeshil. Produkti i Kartonit Jeshil është produkt ndërkombëtar sigurimi, i cili lëshohet në monedhën Euro, pasi edhe detyrimet që i linden shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për pagesë dëmshpërblimi nga ky sigurim janë në Euro. Polica kufitare lëshohet në pikat e kalimit kufitar gjatë hyrjes së automjeteve me targa të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pagesa e primit të policës në monedhën vendase do të vështirësonte procesin e pajisjes së konsumatorit me këtë policë sigurimi. Po kështu, disa nga produktet kryesore të aktivitetit të sigurimit, si sigurimi i pronës me përfitues bankat tregtare ose sigurimi i Jetës së debitorit, janë të lidhura ngushtësisht me monedhën e kredisë. Monedha në të cilën disbursohet kredia dikton dhe monedhën e lëshimit të policës, për shkak të nevojës për të rikuperuar në të njëjtën monedhë vlerën e detyrimit, në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Në disa prej fondeve të investimit, natyra e profilit të veprimtarisë kërkon investimin e tyre në aksione apo tituj të tregjeve ndërkombëtare, pra realizohet në valutë. Gjatë gjashtëmujorit të parë 2025 në krahasim me fund vitin 2024, vihet re rënie në peshën specifike që zënë asetet neto të fondeve të investimit që kryejnë aktivitetin në monedhë të huaj, kundrejt totalit të aseteve neto të tregut të këtyre fondeve.

II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve

A. Tregu i sigurimeve

1. Informacion mbi primet e shkruara bruto

Referuar të dhënave për 30.06.2025, primet e shkruara bruto për të gjithë aktivitetin e tregut të sigurimeve Jo-Jetë dhe Jetë rezultojnë në rreth 12.83 miliardë lekë. Rreth 31.4% e tyre është realizuar në monedhën Euro.

Në mënyrë të detajuar, vihet re se përveç produkteve të detyrueshme të Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar, ka edhe disa produkte vullnetare që rezultojnë me të ardhura pothuajse 100% të realizuara në Euro, siç është Sigurimi Kasko, Sigurimi i kombinuar i Aksidenteve personale dhe shëndetit, Sigurimi i Jetës në Udhëtim dhe Sigurimi i Jetës së Studentit. Gjithashtu, produktet që shfaqin një vlerë të primeve të shkruara në përqindje të lartë në Euro janë: Sigurimi i të Gjitha Risqeve në Ndërtim (CAR)¹, Sigurimi i të Gjitha Risqeve në Montim (EAR)², Sigurimi i mallit në transport, Sigurimi i Përgjegjësive dhe Sigurimi i Aksidenteve dhe Shëndetit në aktivitetin e sigurimit Jo-Jetë dhe Sigurimi i jetës dhe shëndetit në udhëtim, Sigurimi i Jetës së studentit, Sigurimi i Jetës me Kursim, dhe “Flexi Plan”³ për Sigurimin e Jetës. Ndërkohë, produktet si Sigurimi i Mallit në Transport apo Sigurimet e pronës paraqesin një nivel të lartë Euroizimi për shkak të interesit të siguruar nga këto kontrata, interes i cili vlerësohet kryesisht në Euro në rastet e import-eksporteve.

Ndryshimet në strukturën e klasave të sigurimit kanë ndikuar në një rritje të lehtë të peshës së primeve të shkruara në euro, në krahasim me totalin e aktivitetit të sigurimeve JoJetë. Referuar grafikut 1, në 30.06.2025 pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit për aktivitetin e Sigurimit Jo-Jetë ka pësuar rritje me rreth 2% krahasuar me fundvitin 2024, duke shkuar në 32.1% nga 30.1%.

Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 30.06.2025, klasat që kanë shfaqur një rritjen më të theksuar të peshës së primeve të shkruara në Euro në krahasim me 31.12.2024, është klasa e Sigurimeve të Përgjegjësive Civile me rritje të peshës me 16.5% (nga 42.7% në 59.2%), Sigurimet e Garancisë me rritje të peshës me 8.7% (nga 22% në 30.7%), Sigurimet e Marinës me rritje të peshës me 7.6% (nga 2.6% në 10.2%), pasuar nga Sigurimet e Mallit në transport me rritje të peshës me 1.8% (nga 62.5% në 64.3%) dhe nga Sigurimet Motorike me rritje të peshës me 1% (nga 23.8% në 24.8%). Ndërsa, rënie në peshë të primeve të shkruara në Euro në krahasim me 31.12.2024, janë: Sigurimet e Pronës me rënie të peshës me 3.7% (nga 54% në 50.3%), Sigurimet Inxhinierike me


¹ Produkt Sigurimi Jo-Jetë, i cili ofron mbulimin me sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e ndërtimit të objekteve dhe gjithashtu edhe për një afat garancie pas përfundimit të punimeve.

² Produkt Sigurimi Jo-Jetë, i cili ofron mbulimin me sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e montimit të makinerive dhe pajisjeve në objektet industriale.

³ Produkt Sigurimi Jete, i cili mbulon humbjen e jetës si pasojë e aksidentit, humbjen e jetës nga faktorë natyrorë, paaftësinë e përhershme të plotë, paaftësinë e përhershme të pjesshme, etj.

rënie të peshës me 1.4% (nga 69.4% në 68%), pasuar nga Sigurimet e Aksidenteve e Shëndetit me rënie të peshës me 0.5% (nga 58.2% në 57.7%).


Grafik 1: Pesha e primeve të aktivitetit të sigurimit Jo-Jetë në EUR kundrejt totalit



Referuar grafikut të mëposhtëm, në 30.06.2025, pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt primeve të shkruara bruto në total për aktivitetin e Jetës ka shënuar një rënie me rreth 1.7%, duke arritur në 24.8%, nga 26.5% që ka qenë në 31.12.2024.

Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 30.06.2025, klasat që kanë shfaqur rritjen më të theksuar të primeve të shkruar në Euro në krahasim me 31.12.2024, janë: Sigurimi Jeta e studentit me 41.2% (nga 45.9% në 87.1%), Sigurimi i Jetës në Grup me rritje të peshës me 21.5% (nga 17.9% në 39.4%), Sigurimi i Jetës me elementë kursimi me rritje të peshës me 6.4% (nga 93.2% në 99.6%), pasuar nga Sigurimi i kombinuar i Jetës, me rritje të peshës me 3.8% (nga 39.6% në 43.4%). Ndërkohë paraqitet me rënie të peshës të primeve të shkruara në Euro Sigurimi Cash Plan me rënie të peshës me 29.8% (nga 59.5% në 29.7%), pasuar nga Sigurimi i Jetës me elementë të ndryshueshëm, me 14.4% (nga 62.2% në 47.8%) dhe nga Sigurimi i Jetës së Debitorit me rënie të peshës me 1.9% (nga 18.2% në 16.3%).

Grafik 2: Peshat e primeve të aktivitetit të sigurimit të Jetës në EUR kundrejt totalit



Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit


Për periudhën 30.06.2025 depozitat e shoqërive të sigurimit arritën rreth 17.7 miliardë lekë duke shënuar një ulje prej 994 milion lekë ose 5.32%. Depozitat në Lekë arritën 10.2 miliardë lekë, ose 57.8% e totalit të depozitave, duke shënuar një ulje prej 1.6 miliardë lekë ose 13.6% krahasuar me 31.12.2024. Depozitat në valutë u rritën në 7.5 miliardë lekë, ose 42.2% e totalit të depozitave, me një rritje prej rreth 6 milionë lekë krahasuar me 31.12.2024.

Në depozitat në valutë, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat zënë rreth 90.1% të depozitave në valutë dhe 38.1% të depozitave totale (lekë + valutë). Krahasuar me 31.12.2024, depozitat në euro janë rritur me 0.64 miliardë lekë ose 10.5% (nga 6.09 mld lekë në 6.73 mld lekë). Depozitat në USD ka një peshë të kufizuar, me 736 milionë lekë me një rënie prej 34 milionë lekë ose 4.5% kundrejt fundvitit 2024, dhe zënë rreth 10% të depozitave në valutë.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2024	30.06.2025	31.12.2024	30.06.2025	31.12.2024	30.06.2025
Tregu Total	11,816	10,215	771	736	6,089	6,731

Grafik 3: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve në total



Grafik 4: Pësja e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



a) Tregu i sigurimeve Jo-Jetë


Përsa i përket tregut të sigurimit Jo-Jetë, për periudhën 30.06.2025, janë investuar 8 miliardë Lekë në depozita në Lekë, ose rreth 55.7% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 6.5 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose rreth 44.3% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat kapin vlerën rreth 60 milionë Euro, ose kundravlerën rreth 5.9 miliardë Lekë. Depozitat e investuara në Euro zënë rreth 90.2% (2024: 88.9%) të depozitave totale në valutë dhe 40% të depozitave totale, pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Depozitat në valutë për 30.06.2025 janë rritur në vlerën rreth 583 milion lekë ose 9.8%. krahasuar me 31.12.2024.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2024	30.06.2025	31.12.2024	30.06.2025	31.12.2024	30.06.2025
Tregu Jo-Jetë	9,940	8,223	663	639	5,292	5,899

Grafik 5: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve Jo-Jetë



Grafik 6: Pësja e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



b) Tregu i sigurimeve të Jetës


Përsa i përket tregut të sigurimit të Jetës, rreth 2 miliardë Lekë janë investuar në depozita në Lekë, ose 68.2% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 0.93 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose 31.8% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat arrijnë vlerën rreth 8.5 milionë Euro, ose kundrvlerën rreth 0.8 miliardë Lekë. Depozitat në Euro zënë rreth 89.6% (2024: 88.1%) të depozitave në valutë dhe 28.5% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Depozitat në valutë për 30.06.2025 janë rritur në vlerën rreth 25 milion lekë ose 2.7%. krahasuar me 31.12.2024, ndikuar edhe nga fillimi i aktivitetit të një shoqërie të re në tregun e jetës. Raporti i depozitave në valutë me depozitat totale, ka pësuar rënie prej 0.7% në krahasim me fundin e vitit 2024.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2024	30.06.2025	31.12.2024	30.06.2025	31.12.2024	30.06.2025
Tregu Jetë	1,876	1,992	107	97	797	832

Grafik 7: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve të jetës



Grafik 8: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave




Informacion mbi Investime të tjera financiare të shoqërive të sigurimit


Investimet financiare të shoqërive të sigurimit për periudhën 30.06.2025, konsistojnë kryesisht në:

- Bono Thesari në Lekë, në vlerën 57 milionë Lekë, të cilat janë investuar nga shoqëritë e jetës. Në krahasim me 31.12.2024 bonot e thesarit nuk kanë pësuar ndryshim.
- Obligacione në Lekë, në vlerën 4.9 miliardë Lekë, nga të cilat rreth 3.7 miliardë janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës dhe 1.3 miliard Lekë nga shoqëritë e jetës. Këto investime janë rritur me rreth 208 milionë Lekë ose 4.4% krahasuar me 31.12.2024. Gjithashtu, shoqëritë e tregut të sigurimeve kanë investuar dhe në obligacione në Euro, në vlerën 16.9 milionë Euro duke reflektuar një rënie krahasuar me fundvitin 2024, me rreth 767 mijë euro ose 4.3%.
- Kuota në fonde investimesh në Lekë, në vlerën 148 milionë Lekë, nga të cilat 122 milionë Lekë janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës dhe 26 milionë lekë nga shoqëritë e jetës. Kuota në fonde investimesh në Euro, në vlerën 372 mijë Euro, të cilat janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës reflekton një rënie me 7 mijë euro krahasuar me 31.12.2024.
- Investimet financiare në valutë në 30.06.2025 janë të gjitha në monedhën Euro dhe përbëjnë rreth 24.8% të totalit të investimeve financiare.

Grafik 9: Investimet financiare në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të investimeve financiare



Grafik 10: Pesha e Investimet financiare në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të Investimet financiare




B. Tregu i Kapitaleve

Tregu Shqiptar i Kapitaleve, i mbizotëruar nga titujt e borxhit të qeverisë që janë kryesisht në lekë, karakterizohet nga një shkallë tepër e ulët e euroizimit. Pjesëmarrësit kryesorë në këtë treg përdorin kryesisht monedhën vendase. Megjithatë, ka edhe emetues privatë të titujve që kanë kryer emetime në valutë. Autoriteti monitoron këtë treg, për të vlerësuar ecurinë e treguesve dhe nevojën për masa specifike.


Tregu i titujve të Qeverisë jashtë tregut të rregulluar (Bursës)

Të dhënat e tregut të titujve të Qeverisë përfshijnë tregtimin e titujve të borxhit të qeverisë mes bankave të licencuara dhe investitorëve individualë apo personave juridikë, në lekë dhe monedhën Euro. Ky treg dominohet nga blerjet e bankave në tregun primar për llogari të investitorëve. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 nuk ka patur transaksione në valutë.

Grafik 9: Tregu i titujve të Qeverisë jashtë tregut të rregulluar (Bursës)




Grafik 10: Tregu i titujve të Qeverisë jashtë tregut të rregulluar (Bursës) në %



1. Bursa Shqiptare e Titujve

Në Bursën Shqiptare të Titujve (ALSE), gjatë vitit 2023, vitit 2024 dhe gjashtëmujorit të parë vitit 2025 janë realizuar transaksione në tituj të Qeverisë Shqiptare dhe obligacione korporative të emetuara nga një institucion financiar jo bankë, të nominuar vetëm në lekë.

Grafik 11: Pesha e transaksioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të transaksioneve në Bursën Shqiptare të Titujve




2. Obligacionet me ofertë private dhe publike


Duke filluar nga dhjetori 2011, emetimi i obligacioneve nëpërmjet ofertave private ka qenë një burim financimi për banka, institucione financiare dhe shoqëri tregtare. Obligacionet janë emetuar në monedhën vendase dhe në valutë të huaj (EUR dhe USD). Totali i shumës së pashlyer të obligacioneve të emetuara nëpërmjet ofertave private në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 është 33,346 milionë lekë, nga të cilat 56 % janë në euro (ekuivalenti në lekë 18,612 milionë) dhe 1.4 % në USD (ekuivalenti në lekë 484 milionë).

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi me vendimin nr. 72, datë 28.04.2023 prospektin e parë për emetimin me ofertë publike të obligacionit të një subjekti financiar jo-bankë në shumën 500,000,000 lekë. Këto obligacione janë pranuar për tregtim nga Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE.


Grafik 12: Obligacionet me ofertë private të emetuara dhe të pashlyera



Grafik 13: Pesha e obligacioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të obligacioneve me ofertë private të emetuara dhe të pashlyera



Grafik 14: Pesha e obligacioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të obligacioneve me ofertë publike të emetuara dhe të pashlyera





C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve

Në 30.06.2025, në tregun e fondeve të investimit kanë kryer aktivitet trembëdhjetë fonde të hapura me ofertë publike, shtatë nga të cilët kryejnë aktivitetin në valutë të huaj, kryesisht në Euro. Fondet e tjera të investimit kryejnë veprimtarinë në monedhën vendase Lekë.

Asetet neto të fondeve të investimit, të cilët kryejnë aktivitetin e tyre në valutë të huaj, janë rreth 59.2 mln Euro (5.806 miliardë lekë) dhe zënë rreth 9.22% të totalit të aseteve neto të tregut. Edhe detyrimet e fondeve që mbahen në valutë të huaj, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj shoqërisë administruese për tarifën e administrimit, ndaj bankës depozitare dhe detyrime për pagesat ndaj kuotambajtësit, zënë rreth 19.31% të detyrimeve të tregut. Asetet neto të fondeve të tjera të investimit, asetet dhe detyrimet e të cilave mbahen në monedhën vendase lekë, janë rreth 57.1 miliardë Lekë dhe zënë rreth 90.78% të totalit të aseteve neto të tregut.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, vlera e aseteve neto të fondeve në valutë ka pësuar rritje të lehtë në krahasim me fundvitin 2024 për shkak të rritjes së veprimtarisë së këtyre fondeve. Megjithatë pesha specifike që këto fonde zënë ndaj totalit të aseteve neto të tregut të fondeve të investimit ka pësuar rënie nga 9.74% në fundvit 2024 në 9.22% në 30.06.2025.

Grafik 14: Vlera Neto e Aseteve të fondeve të investimit



Sa i përket fondeve të pensioneve vullnetare, ato e kryejnë tërësisht aktivitetin e tyre në lekë.

III. Përfundime

Pesha e vlerës së aseteve që administrohen prej subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti është relativisht e ulët. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e mësipërme, niveli aktual i përdorimit të valutës (Euro-s) në tregjet e mbikëqyrura nga AMF është në nivele përgjithësisht të ulta dhe i diktuar nga profili i veprimtarisë së institucioneve të mbikëqyrura.

Autoriteti do të monitorojë zhvillimet në këto tregje dhe më konkretisht do të fokusohet në drejtim të rritjes së transparencës për produktet që iu ofrohen *investitorëve*, veçanërisht në drejtim të evidentimit dhe kuptimit sa më të qartë të rrezikut (të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) të kursit të këmbimit.